

Në bazë të nenit 28 paragrafi 1 pika 10 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, numër 2/18, 34/19, 38/20, 50/22, 84/22 dhe 85/22), nenit 22 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat e Komunës”, numër 48/19) dhe nenit 5 të Vendimit për kushtet, procedurën dhe mënyrën e ndarjes së mirënjohjeve publike dhe shpërblimeve të Komunës së Ulqinit (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat e Komunës”, numër 27/20) Kuvendi i Komunës së Ulqinit, me propozimin e Këshillit për mirënjohje publike nga mbledhja e mbajtur më 30.03.2023, solli

## VENDIMIN

### **për dhënien e titullit „Qytetar Nderi i Ulqinit“**

#### **Neni 1**

Me këtë vendim, titulli “Qytetar Nderi i Ulqinit” i jepet postmorten z. **Simë Gjon Dobrecit nga Ulqini, profesioni i profesorit Doktor i shkencave mjekësore – Dermatolog.**

#### **Neni 2**

I emëruari, me punën, veprimtarinë e tij shkencore dhe politike, kontribuoi dukshëm në përparimin dhe ngritjen e reputacionit në Komunën e Ulqinit dhe ka merita të jashtëzakonshme në fushën e mjekësisë, si dhe në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe publikimin e të së vërtetës ndaj dhunës që ishte në Kosovë, sidomos gjatë vitit 1990, si dhe meritat për pozitën dhe reputacionin e komunës së Ulqinit dhe statusin e saj në raport me qytetet tjera brenda dhe jashtë vendit.

#### **Neni 3**

Titulli jepet në formën e diplomës që është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Diplomën do ta dorëzojë Kryetari i Komunës në mbledhjen solemne të Kuvendit.

#### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në “Fletoren Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e Komunës”, në tabelën e shpalljeve dhe në web-faqen e Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër: 02 -016/23-119-4  
Ulqin, më 30. 03. 2023

KRYETARI  
Ardijan Mavriq